



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 628/2 Prot.

Tiranë, më 28.04.2021

**V E N D I M**

**Nr. 70, Datë 28.04.2021**

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 67, datë 13.04.2021, të paraqitur nga E.V kundër E.A, me detyrë, Shefi i Komisarariatit Rajonal të Policisë Rrugore Tiranë, M.RR, me detyrë, ish Drejtor i Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat (SHÇBA) dhe E.S, me detyrë, Juriste e Komisarariatit Rajonal të Policisë Rrugore Tiranë, për “çdo shkak tjetër<sup>1</sup>”.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës dhe në dokumentacionin bashkëlidhur, subjekti ankuesi në mes të tjerash informon se, në datë 16.01.2019 ka pësuar një aksident rrugor, kur ishte duke udhëtuar me makinën e tij personale. Punonjësi i policisë, gjatë procedurave të verifikimit të ngjarjes ka ngarkuar E.V me përgjegjësi, duke e dënua me gjobë, në vlerën 1.000 lekë. Më pas është paraqitur eksperti i policisë dhe pasi ka parë shënimin e makinave në asfalt, i është drejtuar duke i thënë “*fajtor je ti*”, pa i dhënë mundësi ankuesit që të sqaronte dinamikën e ngjarjes. Me datë 18.01.2019, ankuesi ka takuar Shefin e Komisarariatit, E.A dhe i ka kërkuar që t’i sqaronte ngjarjen duke i dhënë argumente dhe referenca nga Kodi Rrugor, ndërkohë që E.A i është përgjigjur se “*e ke goditur nga pas, fajtori je ti*”. Më pas, në datë 12.02.2019, është ankuar tek M.T, Drejtor i Policisë Rrugore, i cili ishte dhe eprori i E.A, por nuk ka gjetur zgjidhje dhe

<sup>1</sup> Ankuesi pretendon se veprimet kundër tij janë bërë për shkak se është ushtarak dhe të gjithë personat që ka takuar dhe është ankuar, duke filluar nga polici i parë dhe më pas E.A, i kanë thënë “*u bëtë ju ushtria të na jepni mend neve*”.

më pas, është drejtuar në SHÇBA. Pasi nuk ka marrë përgjigje dhe zgjidhje nga personat e lartpërmendur, E.V i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në të cilën ka kërkuar, shpalljen e pavlefshmërisë absolute të fletë gjobës datë 16.01.2019, shpërblimin e dëmit për shqetësimin e shkaktuar dhe përgatitjen e praktikës nga ana e Policisë Rrugore për përfitimin e dëmit të shkaktuar. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin nr. 4463, datë 26.12.2019 ka vendosur, konstatimin e pavlefshmërisë absolute të dënimit me gjobë datë 16.01.2019, detyrimin e palës së paditur që të rimarrë në shqyrtim praktikën e aksidentit dhe moslejimin e ankimit kundër vendimit në lidhje me pavlefshmërinë absolute të aktit. Ankuesi informon se E.A nuk mund të lejonte që vendimi të zbatohet, sepse do dilte e vërteta dhe shkeljet e tija ligjore dhe ka ankimuar vendimin në gjykatën e apelit, për të bllokuar çështjen.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit, detyrimin e E.A të tërheqë dosjen nga gjykata e apelit, të rishkojë aksidentin dhe marrjen e masave kundër shkaktarit të vërtetë të aksidentit.

## **II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua se:**

Në nenin 1 të Ligjit 10221/2010, *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Diskriminimi përkufizohet nga Ligji 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, në nenin 3/1, si: *“..çdo dallim, përvajshim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”*.

Ligji 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Në bazë të nenit 7, të Ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata

ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Ligjin 10021/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

A. Lidhur me pretendimin e ankuesit për diskriminim nga ana e E.A, M.RR, dhe E.S, sa i takon kundërshtimit të përfundimeve të policisë për aksidentin rrugor.

Ankuesi në rastin në fjalë, ka paraqitur informacion lidhur me rrethanat dhe dinamikën e aksidentit dhe ankesat/kërkesat që i ka drejtuar Shefit të Komisarariatit Rajonal të Policisë Rrugore Tiranë, Drejtorit të Policisë Rrugore dhe ish Drejtorit të SHÇBA-së. Gjithashtu, sa i përket veprimeve të kryera në dëm të tij, ai i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, e cila ka dalë me Vendimin nr. 4463, datë 26.12.2019, ku ndër të tjera ka vendosur dhe rimarrjen në shqyrtim të praktikës së aksidentit.

Lidhur me zbatimin e vendimit të gjykatës, Drejtoria e Policisë Rrugore, me shkresën nr. E-21/1, datë 03.03.2020, ka informuar E.V, si vijon: *“Lidhur me detyrimin e palës së paditur që të rimarrë në shqyrtim praktikën e aksidentit sipas këtij procesverbali, me qëllim përpilimin e një procesverbali tjetër, konstatojnë se organi i policisë (si ai në bazë ashtu edhe ai në qendër), pavarësisht vendimit, nuk kanë instrumenta ligjorë për rivlerësimin/anullimin e tij dhe përpilimin e një tjetri, si për shkak të afateve ligjore ashtu edhe për arsye konceptuale dhe proceduriale. Në këto rrethana, Komisaritati Rajonal i Policisë Rrugore pranë DVP Tiranë, ka për detyrë të administrojë dhe respektojë vendimin e mësipërm të kësaj gjykate, duke ia relatuar për veprim (në vend të procesverbalit të shkëljes) dy kompanive të sigurimit, me qëllim që këto subjekte të kenë një indicie ligjore për të kryer veprimet e nevojshme tekniko/financiare në pajtim të këtij vendimi, ose për të kërkuar shqyrtimin e tij në një nivel tjetër të sistemit gjyqësor”*.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se pretendimet e subjektit ankues janë bërë objekt shqyrtimi nga gjykata, e cila ka dalë me vendimin përkatës. Po ashtu, Komisioneri vëren se dhe detyrimi i zbatimit të vendimit të gjykatës<sup>2</sup> nga ana e Komisarariatit Rajonal të Policisë Rrugore, Tiranë nuk bën pjesë në kompetencat e KMD-së, e për pasojë nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

---

<sup>2</sup> Në nenin 142/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, përcaktohet se: “3. Organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore”.

Në nenin 33, pika 4/b, të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: b) përbën abuzim me të drejtën e ankimit para komisionerit, ose është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji...”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, lidhur me sa sipërcituar, Komisioneri arrin në përfundimin se nuk përmbushen kriteret ligjore për pranimin e ankesës, të përcaktuara nga neni 33, pika 4, gërma “b”, të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, dhe për rrjedhojë ankesa nuk pranohet.

Komisioneri i sugjeron ankuesit se, bazuar në Ligjin nr. 8730, datë 18.01.2011, “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përmbartimit Gjyqësor”, dhe atë nr.10031, datë 11.12.2008 “Për Shërbimin Përmbartimor Gjyqësor Privat”, mund t’i drejtohet këtyre institucioneve, që janë dhe organet kompetente, për ekzekutimin e vendimit gjyqësor.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/b dhe 10 të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Mospranimin e ankesës së shtetasit E.V, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga Ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi.

**KOMISIONER**

**Robert GAJDA**